

jo shumë larg Rahovecit/Orahovac. E varrosën në fshatin e lindjes së Videjës/Vidanje.

Burimet: deklarata T.G, FDH-33154; Gjykata e Qarkut Požarevac, K.77/99 (N. Mullaaliu dhe të tjerë), aktgjykimi, 12.11.2000, FDH-1915; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 71; SMIP, *Terroristički...*, III, 421-422; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998.*, <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Hasan (Hasan) Vuçiterna

(1919, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, pensionist, katër fëmijë)

Para se të shkonte në pension, Hasani ka qenë arsimtar në shkollën fillore në Rahovec/Orahovac. Jetonte në bashkësi familjare me shoqen Fetijen, përderisa djemtë e tyre jetonin ndarazi, në anën tjetër të **Rahovecit/Orahovac**. Në datën 20.07.1998, Hasani e kaloi tërë qytetin pa problem duke shkuar te i biri Hidajeti, i cili jetonte në anën tjetër të qytetit. Atë natë, ai ndenji te Hidajeti, ndërsa në mëngjesin e ditës së nesërme, më **21.07.1998**, rreth orës 5:00, doli nga shtëpia. Familjarët kurrë më nuk e kanë parë Hasanin. Një muaj më vonë, familjarët e Hasanit mësuan se në afërsi të ambulancës ishte gjetur një thes me këmishën dhe letërnjoftimin e Hasanit dhe pak para. Këmisha e tij i kishte shtatë vrima nga plumbat në shpinë. Mbetjet mortore të Hasanit ende nuk janë gjetur. Familjarët nuk e kanë paraqitur zhdukjen e tij pranë KNKK-së.

Burimet: deklarata N.N, FDH-849; deklarata H.V, FDH-12936.

Samir (Ibrahim) Shehu

(3.01.1970, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, shofer, dy fëmijë)

Samiri me bashkëshorten dhe foshnjën e vogël jetonin në shtëpinë e njëjtë me nënën e tij, vëllain dhe familjen e tij [**Rahovec/Orahovac**]. Në datën **21.07.1998**, policët hyrën me një autobлиндë në oborrin e tyre. Samiri doli jashtë shtëpisë. Në pyetjen e policëve nëse brenda kishte burra, u përgjigj se ai ishte i vetmi që momentalisht gjendej

në familje. Policët e bastisën shtëpinë dhe duke u larguar e morën Samirin me vete. Të ëmës i thanë se Samirin vetëm do ta merrnin në pyetje dhe, më pas, do ta kthenin shpejt në shtëpi. Samiri nuk u kthye më. Dy muaj më vonë, bashkëshortja e Samirit e lindi djalit Ibrahimin. Mbetjet mortore të Samirit u identifikuan më 15.10.2007. Ishin zbuluar në afërsi të varrezave rome në Rahovec/Orahovac. Mbetjet mortore të Samirit u varrosën përfundimisht në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-861; deklarata H.S, FDH-12928; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, Kt. num. 83/99 (A. Kolašinac dhe të tjerë), aktakuza, 07.08.2000, FDH-8705.

Xhafer (Zenel) Nurkasa

(24.07.1969, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Në fillim të vitit 1997, Xhaferi ka shkuar në Gjermani për punë. Në muajin mars të vitit 1998, ai u kthye në Kosovë. Aderoi në UÇK, pranë shtabit lokal në Drenoc/Drenovac. Kur në Rahovec/Orahovac filluan konfliktet, Xhaferi me njësitin e tij gjendeshin në pozicionet në afërsi të qytetit. Në datën **21.07.1998**, nga ora 20:30, Xhaferi ka rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua te vendi i quajtur *Të Rrasat/Ploçe* [**Rahovec/Orahovac**]. Një ditë më vonë, e varrosën në Malishevë/Mališevo në prani të familjarëve dhe bashkëlufëtareve. Pas përfundimit të luftës, më 17.07.1999, mbetjet mortore të Xhaferit u rivarrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata S.N, FDH-34339; SHFDUÇK, *Feniksë...10*, 260-263.

Mizahir (Jetullah) Isma

(26.6.1964, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, inxhinier i elektronikës, pjesëtar i UÇK-së)

Bekim (Shaban) Isma

(10.03.1971, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, mekanik, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Arian (Qamil) Brahimi

(7.04.1974, shqiptar nga Shkodra [Shqipëri], pjesëtar i UÇK-së)